



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 5 Prill 2021

Nr: 20

VENDIM

“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 11 DATË 02.04.2021, TË PARTISË DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET (PDIU) ME OBJEKT “KUNDËRSHTIMIN E VENDIMIT NR. 193, DATË 31.03.2021 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Kryesues
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilijan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

Ankues : Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), përfaqësuar nga z. Shkëlqim Sulo;

Palë e interesuar: Partia Lëvizja Socialiste për Integrim

OBJEKTI: Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 11 të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) me objekt “Ndryshimin e vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të



Data: 5 Prill 2021
Nr. 20 Ora 11:00

“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 11, datë 02.04.2021, të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”

Votave (GNV) për zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 prill 2021”, duke vendosur caktimin e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, të marrë pjesë në shortin për anëtarin e katërt të GNV-së”.

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 65, 95, 96, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe nenet 19, 21, 30, 31 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.
2. Në përfundim të afatit për regjistrimin e listave shumëpartore në KQZ, janë regjistruar gjithsej dy koalicione zgjedhore, koalicioni me shkronja nistore (PD-AN) dhe koalicioni me shkronja nistore (ABEOK), 10 (dhjetë) parti politike, dhe 5 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) në zbatim të nenit 95, paragrafi 2 dhe nenit 96, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve nr.5, datë 16.03.2021 “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, organizon në seancë publike hedhjen e shortit, ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve.
4. Në arsyetimin e vendimit të tij, nr. 193/2021 KSHZ parashtron se partitë politike që kanë fituar në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017, jo më pak se dy mandate, përveç partive që propozojnë



kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-së, janë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU). PDIU nuk është subjekt zgjedhor pasi në zbatim të pikës 1 të nenit 63 të K.Zgjedhor “*Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod*”. PDIU është anëtare/pjesëtare e koalicionit PD-AN dhe nuk ka paraqitur listë shumemërore të vetën. Bazuar në nenin 65 pika 3 të Kodit Zgjedhor, në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë udhëheqëse të koalicionit, si dhe marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, që është pjesë e dokumentacionit që depozitohet në KQZ. Për këto arsye, nga partitë e opozitës parlamentare, LSI përmbush kriterin e numrit të mandateve dhe i lind e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve. PDIU, si parti e koalicionit PD-AN nuk legjitimohet të propozojë anëtarin e katërt të GNV-ve, për arsye se të drejtat e saj si subjekt janë përmbushur nga partia udhëheqëse e koalicionit (Partia Demokratike).

Me vendimin nr. 193, datë 31.03.2021, KSHZ vendosi se partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.03.2021, është Partia Socialiste e Shqipërisë dhe partia politike e opozitës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.03.2021, është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

5. Kundër vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të KSHZ-së ka paraqitur ankim Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, ku ka parashtruar se argumenti mbi të cilin u mbështet Komisioneri në vendimin e tij që PDIU nuk ka të drejtën e propozimit të numëruesit, sepse është pjesë e koalicionit, është i gabuar, pasi në marrëveshjen e koalicionit PD-AN në asnjë rast nuk është shënuar ndonjë detyrim për t’ a shmangur nga e drejta që kanë si parti parlamentare e opozitës me më shumë se dy mandate për të caktuar një anëtar të GNV-së. Partia politike ankuese, PDIU, parashtron se vendimi nr. 193/2021 i KSHZ-së nuk është në përputhje me nenin 19 të Kodit Zgjedhor dhe parimin e baraspeshimit politik në përbërjen e Grupeve të Numërimit të Votave. Për këto arsye subjekti ankues kërkon ndryshimin e vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe caktimin e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet për të marrë pjesë në shortin për anëtarin e katërt të GNV-së.



6. Pala e interesuar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) parashtron se PDIU në momentin e regjistrimit si koalicion zgjedhor me parti udhëheqëse Partinë Demokratike, e ka humbur legjitimitetin për të vepruar në emër dhe për interes të vet, dhe ky legjitimitet i delegohet në cilësinë juridike të mbrojtjes së të drejtave dhe detyrimeve, partisë udhëheqëse të koalicionit. Pra, PDIU nëpërmjet përfshirjes në koalicionin PD-AN, ka pranuar me marrëveshje që të delegojë të drejtat që mund ti ushtronte vetë kryesuesit të të koalicionit/partisë udhëheqëse. Mungesa e saj (PDIU) në fletën e votimit si sigël, emër subjekti, emër kryetari dhe mospasja e një liste kandidatësh në 12 qarqe, është tregues i qartë i moslegjitimitetit të saj për të përfituar numërues në tavolinat e numërimit. Për këto arsye, pala e interesuar, LSI, kërkon rrëzimin e kërkesës ankimore të subjektit ankues PDIU dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 139, datë 31.03.2021 të KSHZ-së “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

7. Ankimi iu paraqit Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili caktoi me short si relator z. Koli Bele. Në seancën e datës 03.04.2021, KAS-i me vendimin nr. 18, vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 05.04.2021, në ora 11:00.

8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Vendimin nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”;
- Udhëzimin nr. 05, datë 16.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave”;
- Vendimi nr. 10, datë 06.06.2019 i Kolegjit Zgjedhor, Tiranë.
- Vendimin nr. 386, datë 12.06.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 qershor 2017”;
- Vendimin nr. 107, datë 02.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD), “PD-AN, për “zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”;



- Vendimin nr. 555, datë 26.07.2017 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017”;
- Marrëveshjen e koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim depozituar në
- KQZ në datë 24.02.2021 me shkresën nr. 1482 prot;
- Parashtrimet e palës së interesuar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, depozituar pranë KQZ-së me shkresën nr. 3247 prot. datë 05.04.2021

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU) është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me Kryetar z. Shpëtim Idrizi, me vendimin, nr. 33, datë 05.02.2021. Në datën 24.02.2021, PDIU, bashkë me njëmbëdhjetë parti politike të tjera të regjistruara pranë KQZ-së, kanë kërkuar regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” (PD-AN) si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur kësaj kërkesë është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit ku partitë pjesëmarrëse kanë shprehur vullnetin e tyre për të qenë pjesë e këtij koalicioni dhe ndër të tjera kanë caktuar Partinë Demokratike si parti udhëheqëse të koalicionit, referuar nenit 65, paragrafi 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar.
2. Në momentin e regjistrimit të koalicionit PD-AN, me vendimin e KSHZ-së nr. 107, datë 02.03.2021 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD), “PD-AN, për “zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, subjekti ankues PDIU nuk mund të konsiderohet më në cilësinë e subjektit zgjedhor, duke qenë se këtë status tashmë e ka fituar koalicioni në të cilin PDIU bën pjesë. Ky argument përforcohet me faktin se PDIU nuk ka depozituar një listë të vetën shumëmemërore, nuk përfshihet në fletën e votimit me emrin dhe siglën e saj si parti më vete, por gjithmonë si pjesë e koalicionit PD-AN.
3. KAS vëren se sipas nenit 65 të Kodit Zgjedhor, regjistrimi i PDIU-së si koalicion zgjedhor së bashku me partitë e tjera, sjell si pasojë humbjen e së drejtës për të marrë pjesë në koalicion



tjetër përveç atij ku është regjistruar, dhe gjithashtu humbjen e të drejtës për të paraqitur kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë. Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor me anë të ligjit nr. 118, datë 05.10.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, në nenin 65 është shtuar pika e tretë, e cila parashikon se *në momentin e regjistrimit të një koalicioni zgjedhor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore që përcaktohen nga Kodi Zgjedhor për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, do të përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit*”.

4. Detyrimi i vendosur nga neni 65, paragrafi 3 i Kodit Zgjedhor nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm me përcaktimin e një partie udhëheqëse të koalicionit, nëse kjo parti nuk do të kishte një “status të veçantë” në krahasim me partitë e tjera. Pra, me vullnetin e tyre të lirë partitë politike zgjedhin mes tyre atë udhëheqëse, në mënyrë që kjo e fundit të ushtrojë në emër dhe për interes të të gjitha partive pjesëtare të koalicionit, të drejtat dhe detyrimet që i njihen çdo subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje.
5. Me vendimin nr 10, datë 06.06.2019, Kolegji Zgjedhor ka vendosur rrezimin e padive të palëve paditëse PD dhe LSI, për shkak se nuk konsideroheshin subjekte zgjedhore. Interpretimi që Kolegji i bën termit “subjekt zgjedhor” në këtë vendim, është i tillë që përfshin: *“ata subjekte të cilët në funksion të realizimit të programit të tyre, si dhe të prezantimit të pikëpamjeve të veta, është parashikuar të paraqesin edhe listat shumemërore të kandidatëve. (...) Pra është e dukshme se dy subjektet politike PD dhe LSI, përse nuk kanë paraqitur listë kandidatësh, nuk kanë cilësinë e subjektit zgjedhor”*.

Në analogji më çështjen në fjalë, as PDIU nuk mund të konsiderohet subjekt zgjedhor sipas interpretimit të Kolegjit Zgjedhor, sepse nuk ka depozituar lista të vetat shumemërore. Për më tepër, nëse i referohemi listave shumemërore që subjekti zgjedhor PD – AN ka depozituar në KQZ, kandidatë nga PDIU ka vetëm në 5 nga 12 zonat zgjedhore, më konkretisht në Durrës, Elbasan, Fier, Tiranë dhe Vlorë, çka do të thotë që në 7 zona të tjera zgjedhore, PDIU si parti politike, nuk ka asnjë interes në numërimin e votave çka është dhe kompetenca e GNV-ve. Ndaj interpretimi i KAS shkon dhe në përputhje me frymën e *ratio legis* të neneve 95 dhe 96 të K.Zgjedhor.



6. Neni 95, paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor parashikon se “GNV-të përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të Kodit Zgjedhor”. Më pas, në nenin 96 paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor parashikohet se “Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare”.
7. Referuar nenit 96 të Kodit Zgjedhor, dhe Udhëzimit nr. 5/2021 të KSHZ-së “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”, Komisioneri, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, organizon në seancë publike hedhjen e shortit, ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve.
8. Vendimi nr. 555, datë 26.07.2017 i KQZ-së ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë, ku numri i mandateve të fituara është si vijon:
- Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) 74 mandate
 - Partia Demokratike (PD) 43 mandate
 - Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) 19 mandate
 - Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) 3 mandate
 - Partia Social Demokrate e Shqipërisë (PSD) 1 mandat

Mbështetur në rezultatin e mësipërm, KSHZ ka vendosur në vendimin nr. 193/2021 se partitë politike që kanë të drejtën e propozimit të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-ve janë PS dhe PD, dhe si të tilla këto parti nuk renditen në listën e partive që do të propozojë anëtarin e



tretë dhe të katërt të GNV-ve. Nga partitë e shumicës, PSD nuk përmbush kriterin e numrit të mandateve, prandaj është PS që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të GNV-ve; ndërkohë që nga partitë e opozitës është LSI që ka të drejtën e propozimit të anëtarit të katërt të GNV-ve.

9. Në rastin konkret, duke marrë parasysh se në marrëveshjen e koalicionit të depozituar pranë KQZ-së nga partitë pjesëmarrëse të koalicionit PD-AN, në pikën 3 të kësaj marrëveshjeje, është përcaktuar si parti udhëheqëse Partia Demokratike, automatikisht **të gjitha të drejtat e rezervuara për partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni** do të ushtrohen vetëm nga kjo parti udhëheqëse. Ndër këto të drejta, përfshihet edhe e drejta për të marrë pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve. Duke marrë parasysh se PD është partia që propozon nënkryetarin e KZAZ-ve, ajo ka të drejtën e propozimit të numëruesit të dytë të GNV-ve.
10. Bazuar në nenin 96, pika 1/1 të Kodit Zgjedhor: *“nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik”*. Pra, hipotetikisht, edhe nëse PDIU do të pretendonte që e drejta e propozimit të anëtarit të katërt ti kalonte PD-së si parti udhëheqëse e koalicionit, kjo gjë do të ndodhte vetëm nëse asnjë nga partitë e tjera të opozitës nuk do të përmbushnin kriterin e numrit të mandateve, por në rastin konkret, nga partitë e opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të GNV-ve, LSI i përmbush kriteret e nenit 96, prandaj e drejta e propozimit të anëtarit të katërt kalon automatikisht te LSI.
11. KAS i gjen me vend parashtrimet e palës së interesuar, LSI, kur shprehet se PDIU nëpërmjet përfshirjes në koalicionin PD-AN, ka pranuar me marrëveshje që të regjistrohet si parti pjesëmarrëse duke deleguar të drejtat që mund ti ushtronte vetë kryesuesit të koalicionit/partisë udhëheqëse. Mungesa e saj në fletën e votimit, si sigël, emër subjekti, emër kryetari dhe mospasja e një liste kandidatësh për 12 qarqet, është tregues i qartë për tu marrë në konsideratë lidhur me faktin që PDIU që nga momenti i përfshirjes në një koalicion e ka humbur statusin e subjektit zgjedhor si dhe legjitimitimin e saj për të përfituar numërues në tavolinat e numërimit. Tashmë subjekt zgjedhor është Koalicionin PD – AN që ka depozituar listat shumëmbrore, pjesë e të cilave janë dhe kandidatë nga PDIU.



12. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues se në marrëveshjen e koalicionit nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur e drejta e partisë udhëheqëse për të marrë pjesë në short për caktimin e anëtarëve të GNV-ve, KAS arsyeton se marrëveshja e lidhur mes 12 partive pjesëmarrëse të koalicionit është një kontratë që sjell të drejta dhe detyrime për palët sipas vullnetit të tyre, por nuk mund të dalë kurrësi jashtë kornizës ligjore të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Disa nga detyrimet që kjo kornizë ligjore përcakton janë: caktimi i një partie udhëheqëse; pjesëmarrja në zgjedhje nën emrin dhe logon e koalicionit dhe jo si parti më vete; depozitimi i listave shumëmemërore nga koalicioni dhe jo nga partitë më vete etj.

13. Fjalja e dytë e pikës 3 të nenit 65 të K.Zgjedhor ku parashikohet se *“Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”* është shteruese sa i përket të gjitha të drejtave që subjektet zgjedhore gëzojnë. Fakti që ligjvënësi nuk e ka ndryshuar nenin 96 të K.Zgjedhor në lidhje me të drejtën e partive për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, por ndërkohë, përjashtimisht për partitë politike pjesëtare të një koalicioni subjekt zgjedhor, ka ndryshuar pikën 3 të nenit 88 të K.Zgjedhor, që tashmë parashikon se *“KQZ-ja përlllogarit shumën që i takon secilës parti, duke shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj. Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlllogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre”*, tregon qartë vullnetin e ligjvënësit për veçimin e një të drejte specifike siç është ajo e financimit të partive politike.

Për këtë shkak, konsiderohet se partitë pjesëmarrëse në koalicion, përfshirë PDIU, në momentin e përcaktimit të partisë udhëheqëse të koalicionit PD-AN, si detyrim që buron nga paragrafi 3 i nenit 65 të Kodit Zgjedhor, rrjedhimisht kanë pranuar të delegojnë këto të drejta dhe detyrime.

PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja ‘b’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe



mbështetur në shkronjën 'b' të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shumicë votash, KAS,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.11, datë 02.04.2021 të subjektit ankues Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr.193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Koli	BELE	-	Kryesues
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Iirjan	RUSMALI	-	Anëtar (Kundër)
Ledio	BRAHO	-	Anëtar



MENDIM PAKICE

1. Numërimi i votave në zgjedhje bëhet nga grupet e numerimit të votave (GNV), të cilat përbëhen nga katër anëtarë. Anëtarësia në grupin e numerimit është detyrë publike, e cila ushtrohet në emër të ligjit. Rrethi i detyrave të anëtarit të GNV-së, mënyra e emërimit, procedurat, afatet, përfitimet, disiplina dhe llogaridhënia janë përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ngritja e GNV-ve bëhet në bashkëveprim me partitë politike që gëzojnë të drejtën e propozimit të kandidaturave për anëtarë të GNV-ve, bazuar në parimin e barazpeshimit politik (dy anëtarë nga shumica, dy anëtarë nga opozita parlamentare), por anëtarët e GNV-ve nuk janë në detyrë për të numëruar votat e partive që i propozojnë. Ata nuk janë në detyrë me tagra përfaqësimi, sikurse interpretohet rëndom, por si administratorë zgjedhorë. Nëse prezenca lexohet si përfaqësim, atëherë ata përfaqësojnë në gjysmën e tyre gjithë shumicën parlamentare dhe në gjysmën tjetër gjithë opozitën parlamentare.

Që një parti politike të mund të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidatura për anëtarë të GNV-ve duhet të plotësojë këto kushte dhe kriteret:

- Të jetë parti parlamentare;
- të jetë regjistruar në zgjedhje;
- të ketë fituar jo më pak se dy mandate parlamentare.

Në rast se numri i partive të shumicës ose të opozitës që plotësojnë kriteret është më i madh se numri i vendeve takuese në GNV, atëherë për vendin e tretë dhe të katër hidhet shorti.

2. Tagri për të propozuar kandidaturat për anëtarë të GNV-ve është përcaktuar në Kodin Zgjedhor (nenet 95 dhe 96), së bashku me shkaqet ligjore që sjellin fitimin ose humbjen e këtij tagri. Shkaqet ligjore kanë lidhje vetëm me rrethana fakti, të cilat ekzistojnë ose jo dhe mbi të cilat KQZ-ja nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë ndikim. KQZ-ja nuk mund të pranojë apo refuzojë, miratojë apo rrëzojë as ekzistencën e tyre, as të drejtat e subjekteve që burojnë prej tyre. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në pikën e fundit të nenit tranzitor 183 se në zgjedhjet e datës 25 prill 2021 “e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-



ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve”. Në bazë të këtij kushti dhe të kritereve të neneve 95 dhe 96 të KZ, partitë politike që legjitimohen për propozimin e kandidaturave për anëtarë të GNV-ve janë Partia Socialiste (PS), Partia Demokratike (PD), Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU). Për shkak se PD, LSI dhe PDIU duhet të ndajnë propozimet për dy vende në GNV, Kodi kërkon që për vendin e katër të hidhet short midis LSI-së dhe PDIU-së.

3. Tagri për të propozuar kandidaturat për anëtarë të GNV-ve nuk tjetërsohet, sepse tjetërsimi prish parimin e barazpeshës. Kodi përcakton në pikën 3 të nenit 95 të tij, se kur partia politike nuk propozon kandidatura në afat, atëhere KZAZ-ja cakton anëtarin/anëtarët përkatës zëvendësues me short midis anëtarëve të KQV-ve që i përkasin të njëjtit subjekt në rang zone zgjedhore dhe në rast se nuk është i mundur plotësimi, atëhere vendi mbetet bosh. Tagri për të propozuar kandidatura bie, kur partia politike e regjistruar në zgjedhje nuk merr pjesë në to (nuk regjistron lista kandidatësh) as si subjekt më vete, as si koalicion. PDIU merr pjesë në këto zgjedhje në kuadër të koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-AN).
4. Pala e interesuar LSI ngriti pretendimin në seancë se PDIU “ka humbur legjitimitetin për të vepruar në emër dhe për interes të vet dhe se ky legjitimitet i ka kaluar, i është deleguar në cilësinë juridike të mbrojtjes së të drejtave dhe detyrimeve, partisë udhëheqëse të koalicionit”. Pala e interesuar referon tek pika 3 e nenit 65 të KZ për të mbështetur këtë pretendim, sipas së cilës “për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ”. Ky citim nuk ka asnjë lidhje me pretendimin e palës së interesuar, nuk mbështet pozicionimin e saj kundër palës ankuese, për më tepër nuk mbështet pretendimin për kalimin e tagrit për të caktuar anëtarin e katër të GNV-së nga PDIU tek LSI.
5. Dispozita e nenit 65 është dispozitë e posaçme për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore. Pika 3 e nenit 65 të KZ kur i referohet termi “subjekt zgjedhor” nuk mund t’i referohet çdo subjekti zgjedhor, por bën fjalë vetëm për të drejtat dhe detyrimet e koalicionit si subjekt zgjedhor, marrëdhëniet që krijohen nga koalicioni, për shkak të koalicionit. Koalicioni zgjedhor, në



ndryshim nga partia politike e regjistruar në zgjedhje nuk ka personalitet juridik, nuk ka adresë dhe seli të regjistruar, nuk ka organe drejtuese dhe përfaqësuese, nuk ka organe përgjegjëse ndaj të tretëve. Për këtë qëllim duhet dispozita e pikës 3 të nenit 65 të KZ. Dispozita deklaron se për ushtrimin e tyre është përgjegjëse partia udhëheqëse e koalicionit, ndërsa llogaridhënese kundrejt partive simotra ajo bëhet sipas marrëveshjes së koalicionit. Dispozita do të thotë se për të drejtat dhe detyrimet e koalicionit si subjekt zgjedhor KQZ-ja nuk shkon tek çdo parti e koalicionit, por vetëm tek partia udhëheqëse e tij dhe anasjelltas, jo çdo parti e koalicionit mund të kërkojë ndonjë gjë nga KQZ-ja në emër të koalicionit, por vetëm partia udhëheqëse e tij. Kjo marrëdhënie ka lidhje sidomos me kapitullin e financimit, detyrimeve për raportim e llogaridhënie kundrejt KQZ-së, të cilat mbulohen nga partia udhëheqëse për llogari të të gjithë koalicionit. Kjo dispozitë nuk përfshin aspak të drejtat apo tagrat e ankuesit që burojnë nga qenia e tij parti parlamentare e regjistruar në zgjedhje, sikurse është tagri për të propozuar anëtarë në GNV. Edhe arsyetimi në të kundërt e lë zbuluar palën e interesuar LSI në pretendimet e veta. Nëse gjykojmë për një moment se marrëveshja e koalicionit ka shkaktuar cedimin e të drejtave tek partia udhëheqëse e koalicionit, atëherë anëtari i katër i GNV-ve duhet të ndahej midis LSI-së dhe PD-së, si “suksessore” e PDIU-së, por nuk mund t’i kalojë një subjekti të tretë. Në asnjë rast LSI-ja nuk mund të pretendojë, për këtë shkak, të marrë e vetme të drejtën për të propozuar anëtarin e katër të GNV-ve. Nga ana tjetër, as argumenti i ankuesit PDIU se mungesa e marrëveshjes së shprehur me partinë udhëheqëse të koalicionit për të drejtën e propozimit të anëtarit të katër të GNV-së ia konservon asaj të drejtën e propozimit nuk vlen për trajtimin ligjor të çështjes. Sikurse u argumentua më sipër tagri i propozimit të anëtarit të GNV-së është e drejtë e patjetërsueshme dhe çdo marrëveshje në këtë sens do ishte në çdo rast e kundraligjshme.

6. Partia Demokratike është gjithashtu parti pjesëmarrëse e koalicionit PD-AN. Nëse ajo nuk e ka kaluar të drejtën e vet ligjore për të caktuar një anëtar në GNV tek partia udhëheqëse e koalicionit, atëherë edhe PDIU nuk mund ta kalojë këtë të drejtë. Në fakt Partia Demokratike këtë të drejtë e ka fituar dhe KQZ-ja ia ka njohur si të tillë, për shkak se është partia kryesore e opozitës parlamentare në kuptimin e nenit 183 të Kodit Zgjedhor, jo për shkak se është partia udhëheqëse e koalicionit PD-AN.
7. Arsyetimi sipas pikës 5 më sipër vlen edhe për trajtimin e pretendimit të palës së interesuar LSI për moslegjitimin e palës ankuese, për shkak se ka ceduar të drejtat e veta tek partia



udhëheqëse e koalicionit. Pala ankuese nuk i është drejtuar KAS-it në emër dhe për llogari të koalicionit PD-AN, por në emër dhe për llogari të vet. Si parti politike e regjistruar në zgjedhje me vendimin e Komisionerit nr.33, datë 5.2.2021 PDIU gëzon të drejtën për të vënë në lëvizje KAS-in për mbrojtjen e interesave të veta të ligjshme. Ankimi i paraqitur në KAS nuk ka lidhje me të drejta dhe detyrime të koalicionit. Këto të fundit PDIU nuk mund t'i përfaqësojë.

8. Shumica vendimarrëse e KAS-it ka arsyetuar në vendim, se pala ankuese PDIU ka humbur statusin e subjektit zgjedhor në momentin e regjistrimit të koalicionit PD-AN, ku ajo ben pjesë. Ky qëndrim është i kundraligjshëm, sepse nuk ka asnjë bazë dhe mbështetje ligjore. Nuk ka asnjë dispozitë në Kodin Zgjedhor që të shprehë se, me regjistrimin e koalicionit, subjektet zgjedhore përbërëse të tij pushojnë së ekzistuari. Referenca tek pika 1 e nenit 63 të Kodit është pa lidhje me pretendimin. Interpretimi semantik i pikës 1 të nenit 63, për më tepër i gabuar, nuk e ndihmon shumicën vendimarrëse në arsyetimin e saj. Pika 1 e nenit 63 të Kodit përsërit përkufizimin e subjekteve zgjedhore që është dhënë me pikën 5 të nenit 2 të KZ (“Koalicion” është grupimi i dy apo më shumë partive politike për të konkurruar së bashku në zgjedhje, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod), duke shtuar vetëm nevojën për të paraqitur “listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod”, që të mund të ruash statusin e subjektit zgjedhor e që të vazhdosh garën. Dispozita nuk kërkon “listë të veçantë kandidatësh” për të ruajtur statusin, sikurse keqinterpreton shumica, por listë kandidatësh “sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod” Lista e përbashkët e koalicionit është listë kandidatësh e formatuar sipas rregullave të Kodit. Ajo listë përfaqëson vullnetin e partive politike pjemarrëse të koalicionit, jo vullnetin e partisë udhëheqëse të tij. Fakti që shumica njih dhe pranon se pala ankuese PDIU ka kandidatët e saj në 5 ngja 12 zonat zgjedhore, brenda listës së koalicionit, do të thotë se PDIU e ka plotësuar kriterin e pikës 1 të nenit 63 për të qenë subjekt zgjedhor.
9. Edhe arsyetimi në të kundërt, nuk e mbështet dot ligjërisht pretendimin e shumicës. Nëse partia pjestare e koalicionit humbet statusin e subjektit zgjedhor, si ka mundësi që ligji parashikon për të fonde fushate? Si ka mundësi që partia gëzon të drejtën e minutazhit falas në radiotelevizionin publik? Si ka mundësi që ajo gëzon të drejtën për të marrë kopje të listave të zgjedhësve? Si ka mundësi që ajo ka hapësirën të vëzhgojë procesin e votimit dhe të numërimit (koalicionit i takojnë deri tre vëzhgues, ndryshe nga subjektet parti politike)? Si ka mundësi që ajo gëzon të drejtën për të vënë në lëvizje administratën zgjedhore, Komisionerin, KAS-in



apo Kolegjin Zgjedhor? Së fundi, si ka mundësi që Komisioneri (apo KQZ-ja më parë) nuk ka shfuqizuar asnjë nga vendimet për regjistrimin e partive politike si subjekte zgjedhore, në momentin e miratimit të koalicioneve për ta, as sot dhe asnjëherë më parë. Ky arsyetim i shumicës vjen vetëm, sepse shumica, në mungesë të argumentave ligjore solide, ka ndjerë nevojën t'i heqë statusin ankuesit që të mbajë në këmbë arsyetimin e vet.

10. Arsyetimi për humbjen e statusit të subjektit zgjedhor është antikushtetues, sepse i heq subjekteve zgjedhore anëtare të një koalicionit të drejtën e aksesit në sistemin e drejtësisë administrative dhe në gjyqësor, gjë që sjell pasoja të rënda për mbarrëvajtjen e mëtejshme të procesit zgjedhor.
11. Arsyetimi është alogjik, sepse KAS-i e ka legjitimuar me vendim të ndërmjetëm palën ankuese dhe ka rrëzuar kërkesën e palës së interesuar LSI, e cila e ngriti pretendimin e saj pikërisht mbi argumentin, se pala ankuese PDIU kishte humbur statusin e subjektit zgjedhor në momentin regjistrimit të koalicionit. Qendrimi i shumicës vendimarrëse se PDIU nuk është më subjekt zgjedhor është kundër vetë vendimit të KAS-it në të njëjtën seancë, i cili ia njohu dhe pranoi statusin palës ankuese, kur e legjitimoi atë.
12. Shumica vendimarrëse pretendon, në kundërshtim me ligjin, se numëruesit janë aty për të numëruar votat e partisë që i propozon dhe se partia që nuk ka shtrirje kudo nuk justifikohet ligjërisht që të numërojë votat e subjekteve të tjera. Këtu shumica gjen *ratio legis* për “leximin” e vet të neneve 95 dhe 96. Anëtarët e grupeve të numërimit janë zyrtarë zgjedhorë, pjesë e administratës zgjedhore, të cilët emërohen në detyrë nga organet eprore të administratës zgjedhore, ushtrojnë funksionet në përputhje me KZ dhe aktet nënligjore të tij, përgjigjen ligjërisht për zbatimin e detyrës dhe përfitojnë shpërblim nga KQZ-ja për angazhimin e tyre në administrimin e procesit. Anëtarët e grupeve të numërimit nuk janë zyrtarë partiakë dhe ligji nuk i ngarkon kurrë me numërimin e votave të partive që i propozojnë. Në arsyetimin e shumicës nuk ka *ratio legis*.
13. Lidhur me formimin e GNV-ve, Kodi përcakton këto detyra për KQZ-në (pika 2 e nenit 96):
 - të përcaktojë me udhëzim të veçantë procedurat për hedhjen e shortit (akt me karakter normativ);



- të organizojë hedhjen e shortit për çdo ZAZ, në prani të partive politike të interesuara (veprim administrativ).

Vendimi i Komisionerit objekt shqyrtimi (vendimi nr.193, datë 31.3.2021) nuk bën pjesë në asnjërën nga këto detyra. Sikurse u theksua më lart, kushtet dhe kriteret ku bazohet tagri i subjekteve për të propozuar kandidatët për anëtarë të GNV-ve përbëjnë rrethana fakti, të cilat ekzistojnë ose jo dhe mbi të cilat KQZ-ja nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë ndikim. KQZ-ja nuk mund të pranojë apo refuzojë, miratojë apo rrëzojë as ekzistencën e tyre, as të drejtat e subjekteve që burojnë prej tyre. E drejta e dhënë nga ligji nuk i nështrohet dot njohjes, pranimit apo miratimit nga administrata publike. Parimi i ligjshmërisë së veprimtarisë së administratës publike nuk e lejon këtë. Ky vendim është marrë nga Komisioneri në kushtet kur KQZ-ja nuk ka asnjë tagër ligjor për të “miratuar” apo “caktuar” partitë propozuese. Në këtë kuptim akti objekt shqyrtimi plotëson kushtin e paligjshmërisë, të parashikuar nga shkronja “a” e nenit 109 të Kodit të Procedurave Administrative, sepse Komisioneri ka vepruar në mungesë të kompetencës për nxjerrjen e aktit administrativ.

14. Për nga natyra e vet vendimi nr.193, datë 31.3.2021 është pjesë e lëndës rregullatore të zgjedhjeve, për pasojë përfshihet në kompetencën e shprehur të Rregullatorit për të miratuar “rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje (pika 1 e nenit 20 të KZ). I të njëjtës natyrë është edhe udhëzimi nr.5, datë 16.3.2021 “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave”. Ndërsa udhëzimi nr.5, datë 16.3.2021 nuk është ankimuar në rrugë ligjore dhe kompetenca e komisionerit nuk i është nështruar shqyrtimit nga KAS-i, vendimi nr.193, datë 31.3.2021 ndodhet në këtë procedurë dhe KAS-i është i detyruar të shqyrtojë nëse akti është nxjerrë brenda tagrave ligjore të Komisionerit, apo është në kundërshtim me to. Kompetenca rregullatore për zgjedhjet është kompetencë ekskluzive e Rregullatorit dhe nuk mund të ushtrohet as nga Komisioneri, as nga KAS-i (shih vendimin e KAS nr.9, datë 23.3.2021 dhe vendimin e KAS nr.19, datë 3.4.2021). Kompetenca rregullatore ushtrohet në kushte të posaçme. Aktet e miratuara në kuadër të saj, si rregull, kanë nevojë për mbështetje dhe konsensus të lartë që të jetësohen, kanë nevojë për balancë vendimarrëse. Marrja dhe ushtrimi i kompetencës nga organi monokratik i KQZ-së e prish rëndë këtë balancë dhe rrezikon të krijojë konfliktualitet. Në këtë kuptim akti objekt shqyrtimi plotëson kushtin e



pavlefshmërisë absolute, të parashikuar nga shkronja “a”, pika “i” e nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, sepse akti vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 20 të Kodit Zgjedhor, e cila ngarkon ekskluzivisht Rregullatorin me kompetencën rregullatore në fushën e zgjedhjeve.

Për të gjitha arsyet e parashtruara më sipër shprehem kundër vendimit të marrë nga shumica e anëtarëve të KAS-it. Në vlerësimin tim, bazuar në rrethanat e çështjes, vendimi i drejtë dhe i ligjshëm për KAS-in duhet të ishte:

1. Të konstatojë pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 193, datë 31.3.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për kuvendin të datës 25 prill 2021”.
2. Komisioneri të zhvillojë procedurat e shortit, sipas përcaktimeve të neneve 96 dhe 183 të Kodit Zgjedhor me subjektet që e gëzojnë këtë tagër sipas ligjit, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet.

Ilirjan RUSMALI



Data: 5 Prill 2021
Nr. 20 Ora 11:00

“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 11, datë 02.04.2021, të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”

17